



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2019

dt 07.12.2019 “PËR RININË”

Në mbështetje të neneve 54, 78, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të një deputeti,

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon çështjet themelore që kanë të bëjnë me rininë, pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, ushtrimin e të drejtave, si dhe strukturat në nivel qendror dhe vendor, që bëjnë të mundur mbështetjen, fuqizimin, pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në zhvillimin e jetës shoqërore, politike, kulturore dhe ekonomike në vend.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të sigurojë kushtet që të rinjtë dhe të rejtat marrin pjesë në jetën shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore në vend;
- b) të garantojë mbështetjen për të rinjtë, nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore, nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të mekanizmave dhe strukturave rinore në vend;
- b) të fuqizojë organizatat dhe grupimet rinore, si mjete të mobilizimit dhe pjesëmarrjes shoqërore në jetën demokratike të vendit;
- c) të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore, qendrore dhe vendore, për të hartuar politikat dhe buxhetin për rininë.

Neni 3

Parimet themelore

1. Ky ligj bazohet në parimin barazisë dhe të mundësive të barabarta, të mosdiskriminimit dhe të pjesëmarrjes, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Karta e Këshillit të Europës “Për Pjesëmarrjen e të Rinjve në jetën lokale dhe rajonale”, si dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Asnjë i ri nuk mund të diskriminohet, për shkaqet që përbëjnë diskriminim sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shqipëri, në gëzimin e të drejtave apo ushtrimin e përgjegjësisë, të përfitimit të shërbimeve apo të të mirave që vijnë nga zbatimi i këtij ligji.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “I ri / e re” sipas këtij ligji do të konsiderohet personi mbi moshën 14 vjeç dhe nën moshën 30 vjeç.
2. “Rini” përshkruan grupin shoqëror që përfshin të gjithë të rinjtë dhe të rejtat e moshës 15-29 vjeç, me banim në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që janë subjekt i këtij ligji.
3. “Politika rinore” ë të gjitha masat, veprimet dhe aktivitetet e qeverisë, njësisë të qeverisjes vendore, institucioneve në varësi të tyre, si dhe të organizatave rinore, për të mbështetur fuqizimin, pjesëmarrjen dhe zhvillimin e rinisë në vend.
4. “Këshilli Kombëtar i Rinisë” është organi konsultativ në nivel qendror dhe që përbëhet nga një numër i barabartë i përfaqësuesve të institucioneve publike dhe organizatave joqeveritare, këshillave studentorë, qeverive të nxënësve, parlamenteve rinore.
5. “Ministria përgjegjëse” është institucioni shtetëror që brenda fushës së veprimtarisë së saj harton politikat, buxhetin dhe ushtron përgjegjësitë që kanë të bëjnë me rininë.

6. "Koordinatori Kombëtar për Rininë" është personi përgjegjës për koordinimin e punës, veprimeve dhe aktiviteteve të Qeverisë në nivel qendror dhe vendor.
7. "Shërbimi Kombëtar për Rininë" është agjencia përgjegjëse shtetërore për zbatimin e politikave dhe programeve shtetërore në nivel qendror për rininë.
8. "Këshill Rinor Vendor" është organi konsultativ në nivel vendor, që përbëhet nga një numër i barabartë i përfaqësuesve të institucioneve publike vendore dhe organizatave joqeveritare.
9. "Sektori për Rininë në Bashki" janë zyrat dhe personat përgjegjës në njësinë e qeverisjes vendore që ndër të tjera mbulon edhe punën me rininë, si dhe zbatimin e politikave, planifikimin e buxhetit, koordinimin me organizatat rinore në territor dhe organizimin e aktiviteteve për dhe me rininë.
10. "Aleanca e Këshilltarëve të Rinj në Këshill Bashkiak" është një grup *ad hoc* i këshilltarëve të rinj dhe të reja, anëtare të Këshillit Bashkiak, të cilët mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrjen vendore, fuqizimin e të rinjve dhe organizatave të tyre dhe japin këshilla për politika apo programe të reja për të rinjtë në territorin e njësisë së qeverisjes vendore.
11. "Organizata Rinore" janë organizatat jofitimprurëse të regjistruara, që funksionojnë sipas Ligjit për Organizatat Jofitimprurëse dhe që kanë si mision kryesor të punës së tyre adoleshentët ose të rinjtë.
12. "Parlament Rinor" është një formë organizimi të të rinjve dhe të rejave që ndjekin arsimin e mesëm në nivel vendor dhe kombëtar;
13. "Qendra Rinore" janë të gjithë ato mjedise publike, të cilat funksionojnë pranë çdo njësie të qeverisjes vendore dhe që ofrojnë shërbime rinore me ose pa pagesë, për të rinjtë.
14. "Shërbime Rinore" janë të gjitha ato shërbime që kanë për qëllim mbështetjen emocionale, arsimore, këshillimin apo fuqizimin e të rinjve për të marr pjesë dhe kontribuar në jetën shoqërore, ekonomike apo politike në vend.
15. "Karta Rinore" është një shërbim kombëtar për të rinjtë që jepet Shërbimi Kombëtar për Rininë në bashkëpunim me Sektorët e Rinisë në Bashki dhe organizatat joqeveritare rinore.
16. "Puna me rininë" përfshin aktivitetet që organizohen për dhe me të rinjtë, me karakter informues, edukues, ndërgjegjësuës ose mobilizues, që mbështet zhvillimin dhe fuqizimin personal dhe/ose social, në përputhje me aftësinë dhe nevojat e tyre dhe ku të rinjtë marrin pjesë me dëshirën e tyre.
17. "Punonjës Rinor" do të konsiderohet çdo person i punësuar në sektorin publik ose privat që punon me rininë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 5

Fusha e zbatimit të ligjit

1. Ligji zbatohet për çdo person me shtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

KREU II

MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR RININË

Neni 6

Mekanizmat institucionalë këshillimorë, koordinues dhe strukturat për rininë

1. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë për rininë shtrihen në nivel qendror dhe vendor.
2. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë janë:
 - a) Këshilli Kombëtar i Rinisë në nivel qendror;
 - b) Këshilli Rinor në Njësinë e qeverisjes vendore
3. Strukturat për Rininë në nivel qendror janë:
 - a) ministri që bashkërendon punën për çështjet e rinisë / të rinjve;
 - b) Koordinatori Kombëtar për Rininë;
 - c) Shërbimi Kombëtar për Rininë;
 - d) çdo ministër përgjegjës, sipas fushës që mbulon ndër të tjera çështjet e të rinjve;
4. Strukturat për Rininë në nivel vendor janë:
 - a) Bashkia
 - b) Sektori për Rininë në Bashki;
5. Të gjithë mekanizmat dhe strukturat shtetërore në nivel qendror e vendor bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit e të politikave shtetërore për rininë. Mekanizmat dhe struktura bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse rinore dhe grupime rinore, studentore etj. për realizimin e politikave kombëtare e vendore për rininë, si dhe për ofrimin e shërbimeve në zbatim të këtij ligji.

Neni 7

Këshilli Kombëtar i Rinisë

1. Këshilli Kombëtar i Rinisë është organ këshillimor që ngrihet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në përbërje të tij janë 9 përfaqësues nga çdo ministri që ndër të tjera mbulon çështjet e rinisë dhe 9 përfaqësues nga shoqëria civile, sipas kësaj ndarjeje: 3 përfaqësues nga OJF-të rinore, 3 përfaqësues të Këshillave studentore të Universiteteve publike dhe 3 përfaqësues të Qeverisë së Nxënësve ose Parlamenteve Rinore. Mbledhja e Këshillit drejtohet nga Koordinatori Kombëtar për Rininë. Të ftuar në Këshill mund të jenë dhe drejtuesit e Forumeve politike të të rinjve të partitë politike parlamentare. Përbërja e tij ndërtohet mbi bazën e përfaqësimit të barabartë gjinor.

2. Përfaqësuesit e shoqërisë civile përbërëse në Këshill zgjidhen me votim të fshehtë dhe konkurrues nga Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile, sipas procedurave të caktuara prej tij. Përfaqësuesit nga shoqëria civile duhet të jenë shtetas shqiptarë me veprimtari të njohur dhe të verifikueshme për të drejtat e të rinjve dhe të rinjtë.

2. Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga Koordinatori Kombëtar për Rininë.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë është 2 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë të emëruar për shkak të detyrës. Në çdo rast, ripërtëritja e të gjithë anëtarëve të këshillit në të njëjtën kohë është e ndaluar.

5. Në mbledhjet e Këshillit mund të marrin pjesë pa të drejtë vote drejtuesit e Forumeve Politike Rinore të partive politike, organizatave joqeveritare rinore dhe drejtuesit e Këshillave Rinorë Vendorë.

4. Këshilli Kombëtar i Rinisë miraton vetë rregullat e tij të funksionimit.

Neni 8

Detyrat e Këshillit Kombëtar të Rinisë

Detyrat e Këshillit Kombëtar të Rinisë janë:

1. Këshillon Këshillin e Ministrave për drejtimet dhe prioritetet e politikave shtetërore dhe buxhetore për rininë;
2. I propozon Këshillit të Ministrave përmirësime të politikave dhe ligjeve për rininë, miratimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë, si dhe drejtimet e programet kryesore për mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjes e të rinjve në Shqipëri;
3. I propozon Këshillit të Ministrave shtesa dhe përmirësime në politikat dhe legjislacionin ekzistues apo miratimin e politikave, ligjeve dhe programe të reja për rininë;
4. Vlerëson gjendjen e rinisë në vend dhe të zbatimit të politikave rinore, duke propozuar udhëzime dhe rekomandime për ministrinë përgjegjëse, Koordinatorin Kombëtar dhe Shërbimin Kombëtar për Rininë, si dhe propozime e rekomandime për Këshillin e Ministrave për përmirësimin e gjendjes;
5. Miraton raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë.
6. Ngre sipas nevojave të tij grupe pune për çështje të rinisë dhe përcakton përbërjen e rregulloret e tyre.

Neni 9

Ministri përgjegjës për çështjet e rinisë

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e rinisë është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës, i cili, realizon këto detyra:

1. Harton politikat, programet shtetërore dhe strategjitë në fushën e rinisë dhe të shërbimeve për të rinjtë, si dhe planifikon shpërndarjen e buxhetit për zbatimin e tyre në konsultim me organizatat rinore dhe Këshillin Kombëtar të Rinisë;
2. I propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare për çështjet e rinisë, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera për garantimin që ata gëzojnë të drejtat sipas ligjit, përfshirë edhe rekomandimet e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Rinisë;
3. Nxjerr udhëzime për veprimtarinë e strukturave rinore në varësi të Shërbimit Kombëtar të Rinisë dhe rekomandime për organeve të qeverisjes vendore;
4. Siguron ofrimin e shërbimeve për të rinjtë, në bashkëpunim me autoritetet e tjera përgjegjëse, njësitë e qeverisjes vendore, duke përfshirë edhe caktimin e standarteve të përbashkëta të ofrimit të shërbimeve rinore dhe punës me rininë;
5. Bashkërendon punën me autoritetet e tjera përgjegjëse për zbatimin e standarteve të shërbimeve për rininë, si dhe mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve;

6. Të gjitha autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrim ligjor për të bashkëpunuar me ministrin që bashkërendon punën për çështjet e rinisë, në hartimin e politikave, programeve, shërbimeve të përbashkëta në këtë fushë dhe të standarteve të tyre.

Neni 10

Koordinatori Kombëtar i Rinisë

Koordinatori Kombëtar i Rinisë emërohet nga Kryeministri me propozim të Ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë. Ai është përgjegjës ndër të tjera për këto detyra:

- a) Koordinon dhe monitoron zbatimin e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e këtij ligji, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit për rininë, si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e rinisë;
- b) Kontrollon veprimtarinë e Shërbimit Kombëtar të Rinisë dhe të shërbimeve të ofruara prej tij dhe miratonin planin vjetor të aktiviteteve të Shërbimit;
- c) Koordinon, bashkëpunon dhe mbështet ministritë që punojnë ndër të tjera për çështjen e rinisë, Shërbimin Kombëtar të Rinisë dhe Sektorët e Rinisë në njësitë e qeverisjes vendore;
- d) Orienton donatorët vendas dhe të huaj për zbatimin e objektivave të strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për rininë;
- e) Koordinon zbatimin e politikës shtetërore rinore në bashkëpunim dhe duke mbështetur organizatat jofitimprurëse të të rinjve, strukturave këshillimore rinore në njësitë e qeverisjes vendore, forumet politike të të rinjve të partitë politike, grupimet rinore etj;
- f) Bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Rinisë;
- g) Mbledh, analizon dhe bën publike të dhënat e raporteve statistikore e të raporteve të tjera për rininë dhe koordinon me ministrat e tjerë, me qëllim përshtatjen e politikave të rinisë.
- h) Përgatit raportin vjetor të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe të Planit Kombëtar të Veprimit;
- i) Zbaton çdo detyrë e përgjegjësi tjetër të caktuar nga Këshilli i Ministrave, Ministri përgjegjës për rininë ose Këshilli Kombëtar për Rininë.

Neni 11

Shërbimi Kombëtar për Rininë

1. Shërbimi Kombëtar për Rininë është person juridik në varësi të ministritë përgjegjëse për çështjet e rinisë dhe financohet nga buxheti i shtetit.
2. Shërbimi luan rolin e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Rinisë dhe mbështet ndër të tjera edhe Koordinatorin Kombëtar për Rininë.
3. Shërbimi drejtohet dhe përfaqësohet nga kryetari, marrëdhëniet e punës të të cilit rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil. Kryetari duhet të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në pozicione drejtuese në institucione publike ose organizata rinore. Kryetari zgjidhet nga Ministri përgjegjës për çështjet rinore;

4. Struktura dhe organika e Shërbimit miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.
5. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Shërbimit Kombëtar të Rinisë përcaktohen në rregulloren e shërbimit, e cila miratohet nga Ministri përgjegjës për çështjet e rinisë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 12

Detyrat e ministrave

Ministrat, brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore, nëpërmjet strukturave të tyre politikëbërëse, kanë për detyrë:

1. të sigurojnë zbatimin e ligjit nga institucionet në varësi të tyre;
2. të caktojnë një person përgjegjës që do të mbulojë ndër të tjera çështjet e rinisë në ministri dhe do t'a përfaqësojë atë në Këshillin Kombëtar të Rinisë;
3. Të mbledhin, përpunojnë dhe bëjnë publike të dhëna statistikore për rininë, në fushën e veprimtarisë së tyre, sipas metodologjisë dhe indikatorëve të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Rinisë. Të dhënat ndahen periodikisht me Koordinatorin Kombëtar për Rininë;
4. Koordinohen dhe mbështesin punën dhe kërkesat e Koordinatorit Kombëtar për Rininë;
5. Hartojnë politika sektoriale, aktet ligjore e nënligjore të nevojshme për rininë, si dhe të kontribuojnë në hartimin e politikave dhe programeve ndër-sektorialë, duke siguruar edhe përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të rinjve dhe të organizatave rinore në to;
6. Të shoqërojnë çdo projektligj apo projekt-akt normativ që hartojnë me një analizë të ndikimit të tij tek të rinjtë;
7. Të parashikojnë në buxhetin vjetor dhe atë afat-mesëm fondet e nevojshme për përmbushjen e përgjegjësisë së tyre për zbatimin e këtij ligji si dhe të Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe Planit Kombëtar të Veprimit;

Neni 13

Detyrat dhe përgjegjësitë e njësive të qeverisjes vendore

Bashkitë janë përgjegjëse për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative në varësi të tyre të strukturave përkatëse për rininë, duke siguruar, ndërmjet të tjerash:

1. Përgatitjen dhe miratimin e strategjive dhe planeve vendore të veprimit për rininë, në përputhje me politikat kombëtare dhe situatën e të rinjve në territorin e administruar prej tyre;
2. Ngritjen e Sektorit të Rinisë në Bashki. Sektori është pjesë e strukturës organike të Bashkisë dhe mbështetet në ushtrimin e funksioneve dhe realizimin e detyrave nga stafi dhe fondet e bashkisë;
3. Caktimin e të paktën një person përgjegjës në bashki për çështjet e të rinjve.
4. Krijimin e programit buxhetor për rininë në buxhetin e bashkisë për rininë, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak, Këshillin Vendor Rinor dhe organizatat e të rinjve në territor;

5. Zhvillimin e programeve dhe nismave të përbashkëta, në konsultim me Këshillin Rinor Vendor dhe organizatat e të rinjve;
6. Mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave statistikore, në bashkëpunim me institucionet e tjera vendore, për situatën e të rinjve dhe të rejave në territor dhe ndarjen e tyre me Koordinatorin Kombëtar për Rininë;
7. Organizimin dhe ofrimin e shërbimeve rinore, si pjesë të paketës së shërbimeve vendore;
8. Krijimin dhe mbështetjen e Qendrave Rinore si shërbime me bazë komunitare të punës me rininë.
9. Garantojnë që Qendrat Rinore angazhojnë punonjës rinor me eksperience në çështjet rinore. Punonjësit rinorë janë të punësuar të bashkisë.

Neni 14

Këshilli Rinor në Njësinë e qeverisjes vendore

1. Këshilli Rinor në Njësinë e qeverisjes vendore është organ këshillimor që ngrihet me vendim të Këshillit Bashkiak. Në përbërje të tij janë 4 përfaqësues të këshillit bashkiak, përfaqësuesi i Sektorit Rinor në Bashki, dhe 6 përfaqësueses të organizatave jofitimprurëse dhe grupeve rinore në territor, Parlamentit Rinor, Qeverisë së nxënësve etj. Përbërja e tij ndërtohet mbi bazën e përfaqësimit të barabartë gjinor.
2. Këshilli kryesohet nga një prej nën-kryetarëve të Këshillit Bashkiak, sipas vendimit të Këshillit;
3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Rinor është 2 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë të emëruar për shkak të detyrës. Në çdo rast, ripërtëritja e të gjithë anëtarëve të këshillit në të njëjtën kohë është e ndaluar.
4. Në mbledhjet e Këshillit mund të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe drejtuesit/et e Prefekturës, Qarkut apo institucioneve në varësi të Qeverisë qendrore, Forumeve Rinore të partive politike në territor etj.
5. Këshilli Rinor në Njësinë e qeverisjes vendore miraton me konsensus rregullat e tij të funksionimit brenda 3 muajve nga ngitja e tij.
5. Detyrat e Këshillit Rinor në Njësinë e qeverisjes vendore janë:
 - a) Këshillon Bashkinë për drejtimit e politikave dhe buxhetit për rininë;
 - b) Siguron që çështjet e rinisë dhe buxheti rinor përfshihen në të gjitha fushat e punës së Bashkisë;
 - c) I propozon Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë përmirësime të politikave vendore, si dhe programet kryesore për mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjes e të rinjve në territorin e tyre;
 - d) Vlerëson gjendjen e të rinjve dhe të zbatimit të politikave vendore rinore, duke dhënë rekomandime për drejtoritë përgjegjëse të Bashkisë dhe institucionet e tjera publike në territor;
 - e) Miraton raportin vjetor të punës së Bashkisë për Rininë të përgatitur nga Sektori i Rinisë;
 - f) Bashkëpunon dhe shkëmben të dhëna e informacion me Këshillin Kombëtar për Rininë;
 - g) Ngre sipas nevojave të tij grupe pune për çështje të rinisë dhe përcakton përbërjen e rregulloret e tyre.
 - h) Këshilli Rinor mbështetet në veprimtarinë dhe aktivitetet e tij nga Buxheti i Bashkisë, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak;

Neni 15

Sektori për Rininë në Bashki

Drejtuesi i Sektorit për Rininë në Bashki emërohet ose sipas rastit caktohet nga Kryetari i Bashkisë. Ai/ajo është përgjegjës/e ndër të tjera për këto detyra:

- a) Koordinon dhe zbaton politikën, strategjinë, planet vendore dhe aktivitetet e bashkisë për rininë, në bashkëpunim dhe koordinim me organizatat dhe grupimet rinore në territor;
- b) Merr masa për zbatimin e politikave rinore kombëtare duke i bërë ato pjesë të politikave, strategjive, planeve dhe aktiviteteve vendore të veprimit;
- c) Koordinon, bashkëpunon dhe mbështet Bashkinë dhe drejtoritë e saj, që punojnë ndër të tjera për çështjen e rinisë, për të zbatuar politikën, strategjinë, planet vendore dhe aktivitetet e bashkisë për rininë;
- d) Bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Koordinatorin Kombëtar të Rinisë dhe Shërbimin Kombëtar të Rinisë;
- e) Orienton biznesin dhe donatorët në territor për zbatimin e objektivave të politikave, strategjive, planeve vendore dhe aktiviteteve të bashkisë për rininë;
- f) Koordinon zbatimin e politikës vendore rinore në bashkëpunim dhe duke mbështetur organizatat jofitimprurëse të të rinjve, strukturave këshillimore rinore në njësinë e qeverisjes vendore, forumet politike të të rinjve të partitë politike, grupimet rinore etj;
- g) Bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Rinor në Bashki;
- h) Mbledh, analizon dhe bën publike të dhënat statistikore për rininë në Bashki.
- i) Përgatit raportin vjetor të punës së Bashkisë për rininë;
- j) Mbështet punën dhe aktivitetet e organizatave joqeveritare për rininë në territor, sipas procedurave të Bashkisë;
- k) Zbaton çdo detyrë e përgjegjësi tjetër të caktuar nga Këshilli Bashkiak dhe Bashkia.

Neni 16

Buxheti për Rininë

1. Fondet për programet e financimit dhe projektet me interes publik në sektorin e rinisë do të rezervohen në një zë të veçantë në buxhetin e Ministrisë përgjegjëse për Rininë dhe të njësive të qeverisjes vendore. Këto fonde do të përdoren për:

- a) zhvillimin e aktiviteteve rinore përmes inkurajimit të të rinjve për pjesëmarrje aktive në proceset demokratike dhe sociale;
- b) fuqizimin e rrjeteve, organizatave dhe grupimeve rinore, për të marrë pjesë në zbatimin e aktiviteteve dhe objektivave të rinisë të përcaktuara në strategjinë dhe planet e veprimit për rininë;
- c) informimin e të rinjve;
- d) përgatitjen dhe botimin e botimeve me rëndësi për të rinjtë;
- e) mbështetjen e Qendrave Rinore, punonjësit rinorë dhe shërbimet të tyre;
- f) organizimin e trajnimeve, seminareve dhe aktiviteteve për punësimin, vetëpunësimin dhe sipërmarrjen rinore;
- g) nxitjen e edukimit joformal të të rinjve;

- h) fuqizimin shoqëror të të rinjve, veçanërisht përmes inkurajimit të vullnetarizmit dhe punës me të rinjtë, si dhe ngritjes së kapaciteteve të organizatave Rinore;
 - i) inkurajimi i të rinjve për të qenë aktive dhe për të nxitur jetesën e shëndetshme dhe të sigurt, si dhe trajtimin e nevojave të të rinjve në fushën e sportit dhe kulturës;
 - j) inkurajimin e aktiviteteve rinore në nivel lokal përmes mbështetjes dhe zbatimit të planeve lokale të veprimit për të rinjtë, si dhe programeve dhe projekteve të Sektorit të Rinisë dhe Qendrave Rinore;
 - k) kryerjen e Studimeve mbi gjendjen, pozitën dhe nevojat e të rinjve në Shqipëri;
 - l) promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të të rinjve në rajon, me të rinjtë që jetojnë në Bashkimin Europian apo edhe më gjerë;
 - m) krijimin dhe zbatimin e kartës rinore;
2. Procedurat dhe rregullat për shpërndarjen e fondeve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA III

PJESËMARRJA, FUQIZIMI DHE PUNA ME RININË

Neni 17

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi e të rinjve në proceset e vendimmarrjes

1. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv, qeverisjes vendore dhe të partive politike, arrihet kur sigurohet përfshirja jo më pak se 10 për qind e të rinjve në to.
2. Kuvendi, Qeveria, njesitë e qeverisjes vendore dhe partitë politike përcaktojnë mënyrat dhe masat për të përmbushur kërkesën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 18

Mbështetja e organizatave jofitimprurëse rinore

1. Kuvendi, Ministritë, organet e qeverisjes vendore dhe institucionet në varësi të tyre bashkëpunojnë dhe mbështesin organizatat jofitimprurëse të të rinjve në punën dhe veprimtarinë e tyre me dhe për të rinjtë.
2. Mbështetja mund të jetë si në të mira materiale ose nëpërmjet mbështetjes financiare të tyre për të realizuar aktivitete që mbështesin, fuqizojnë, mbrojnë apo rrisin pjesëmarrjen e të rinjve në shoqëri, ekonomi apo vendimmarrje.
3. Rregullat për mbështetjen financiare të organizatave rinore rekomandohen nga Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Puna me Rininë

Puna me rininë është një aktivitet i organizuar përgjithësisht në Qendrat Rinore ose

organizatat joqeveritare që punojnë me dhe për të rinjtë, e cila ka si qëllim të njohë, mbrojë apo zhvillojë interesat dhe nevojat e të rinjve, në përshtatje me moshën e tyre.

Neni 20

Qendrat Rinore

1. Në çdo njësi të qeverisjes vendore hapen qendra rinore. Qëllimi i qendrave është mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve dhe të rejave me shërbime komunitare të mbrojtjes, këshillimit, zhvillimit arsimor joformal dhe të karrierës, si dhe për organizimin e aktiviteteve rinore nëpërmjet punës me të rinjtë.
2. Qendrat Rinore mbështeten dhe financohen në aktivitetet e tyre nga njësia e qeverisjes vendore që administron territorin ku ato ndodhen. Stafi i tyre është në varësi të Sektorit të Rinisë në Bashki;
3. Struktura, roli, funksionet, menaxhimi dhe shërbimet bazë që ofrojnë Qendrat rinore përcaktohen me udhëzim të Ministrit përgjegjës për çështjet rinore në konsultim me njësitet e qeverisjes vendore dhe organizatat joqeveritare rinore;
4. Personeli që punon drejtpërsëdrejti me të rinjtë në Qendër do të konsiderohen punonjës rinorë. Punonjësit rinorë bashkëpunojnë në realizimin e qëllimeve dhe objektivave të tyre me Sektorin e Rinisë në Bashki dhe Shërbimin Kombëtar të Rinisë;
5. Shërbimi Kombëtar për Rininë brenda 6 muajve nga hyrja e ligjit në fuqi propozon për miratim në Këshillin Kombëtar të Rinisë Modelin e Qendrës Rinore, në konsultim të gjerë me Ministrinë përgjegjëse për rininë, njësitet e qeverisjes vendore dhe organizatat joqeveritare;

Neni 21

Administrimi i Qendrave Rinore

1. Qendra rinore administrohet nga Sektori i Rinisë në Bashki, në bashkëpunim me organizatat dhe grupimet rinore në territorin ku vepron ajo. Rregullat dhe procedurat e administrimit të Qendrave përcaktohen me Vendim të Këshillit Bashkiak në njësinë e qeverisjes vendore;
2. Qendra Rinore drejtohet nga një Drejtues Rinor që përcaktohet nga Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore.
3. Drejtuesi/ja e Qendrës Rinore mban një regjistër për numrin e vizitave dhe shërbimet e ofruara për të rinjtë. Informacioni shkëmbehet rregullisht me Shërbimin Kombëtar të Rinisë dhe me Sektorin e Rinisë në Bashki.

Neni 22

Organizatrat rinore

Organizatë rinore do të konsiderohen organizatat joqeveritare të njohura dhe të regjistruara sipas Ligjit për Organizatat Jofitimprurëse, që kryejnë punë rinore ose organizojnë aktivitete për të rinjtë, ku të paktën 70% e pjesëmarrësve dhe përfituesve, janë të rinj sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 23

Punonjësi rinor

1. Punonjës rinor konsiderohet personi që është diplomuar apo është specializuar profesionalisht për të punuar me të rinjtë dhe për të zbatuar aktivitete rinore.
2. Punonjësi rinor mbështet në punën e tij të rinjtë dhe organizatat rinore për të analizuar, planifikuar, organizuar, monitoruar dhe vlerësuar politikat rinore, bazuar në aftësitë personale dhe nevojat specifike të çdo të riu.
3. Programet rinore përfshijnë në aktivitetet e tyre veprime të cilat mbështesin zhvillimin dhe specializimin e punonjësve rinorë.

Neni 24

Karta Rinore

1. Karta Rinore është një shërbim kombëtar për të rinjtë që jepet nga Shërbimi Kombëtar për Rininë në bashkëpunim me Sektorët e Rinisë në Bashki dhe organizatat joqeveritare rinore. Rregullat e përfitimit dhe shpërndarjes së saj përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Nëpërmjet kartës rinore, të rinjtë dhe të rejtat e pajisura me të, përfitojnë ulje në njësitë e shërbimeve të cilat kanë rënë dakord të pranojnë vlefshmërinë dhe përdorimin e kartës.

Neni 25

Komisioneri për të Drejtat e të Rinjve

1. Pranë zyrës së Avokatit të Popullit krijohet Komisioneri për të Drejtat e të Rinjve. Roli dhe funksionet e Komisionerit përcaktohen me Ligjin për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 26

Praktika e punës të të rinjve

1. Të rinjtë në përfundim të shkollës së mesme, gjatë ose pas periudhës së studimeve universitare mund të zhvillojnë praktika pune në institucione shtetërore, organizata joqeveritare ose biznese.
2. Praktika e punës të të rinjve bëhet vetëm përkundrejt pagesës së personit që ushtron praktikën, për orët e punës të realizuara gjatë praktikës. Nuk lejohen praktikat e punës së papaguara të të rinjve;
3. Të rinjtë që duan të përfitojnë nga praktika e punës duhet të lidhin kontratë me Shërbimin Kombëtar të Punësimit Shërbimi, bazuar në kërkesat e të riut / të resë, përcakton oraret e punës në bashkëpunim me institucionin shtetëror, organizatën joqeveritare ose biznesin ofrues të praktikës së punës.

4. Çdo fillim-viti, Shërbimin Kombëtar të Punësimit në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Rinisë, përcaktojnë fushat prioritare dhe institucionet, organizatat dhe bizneset, ku do të realizohet praktika e punës dhe kohëzgjatjen e tyre.
5. Shërbimin Kombëtar të Punësimit lidh kontrata bashkëpunimi me institucionet publike, organizatat joqeveritare dhe biznesin, të cilat duan të bëhen pjesë e shërbimit të praktikës së punës të të rinjve.
6. Pagesa e të rinjve bëhet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.
7. Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Rinisë krijojnë dhe mirëmbajnë së bashku Regjistrin Kombëtar të Praktikave të Punës të të Rinjve. Rregullat për krijimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
8. Rregullat e bashkëpunimit ndërmjet Shërbimit dhe të rinjve, institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare dhe biznesit ofrues të praktikës së punës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të Ministrit përgjegjës për rininë.
9. Çdo subjekt që ofron praktika të punës për të rinjtë ka për detyrë të marr të gjitha masat objektive të mundshme për të eliminuar çdo rrezik ose ngjarje mund të rrezikojë jetën ose mirëqenien fizike, emocionale apo seksuale të të riut ose të resë.

PJESA IV

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet rinore për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 10 pika 5, nenit 19 pika 3 dhe nenin 22 pika 5, brenda afateve të caktuara në këtë ligj.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 10 pika 4, nenit 18 pika 3 dhe nenit 21 pika 1, brenda afateve të caktuara në këtë ligj.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R
Gramoz Ruçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I LËVIZJES SOCIALISTE PËR INTEGRIM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 11.01.2019

Lënda : Depozitimi i projektligjit “Për Rininë” në Republikën e Shqipërisë.

Drejtuar: Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë

Z. Gramoz RUÇI

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 81, pika 1, në cilësinë e subjektit kushtetues për të ndërmarrë nismë legjislative, ne një grup deputetësh të grupit parlamentar Lëvizja Socialiste për Integrim, propozojmë projektligjin “Për Rininë”, i cili rregullon çështjet themelore që kanë të bëjnë me rininë, pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, ushtrimin e të drejtave, si edhe strukturat në nivel qendror edhe vendor, që bëjnë të mundur mbështetjen, fuqizimin, pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në zhvillimin e jetës shoqërore, politike, kulturore dhe ekonomike në vend.

Projektligji është përgatitur në bashkëpunim me një ndër organizatat kryesore të shoqërisë civile, CRCA Shqipëri, ndërkohë që është konsultuar me organizatat rinore dhe me të rinj e të reja në të 12 qarqet e Shqipërisë.

Bashkëngjitur me këtë kërkesë depozitohet projektligji dhe relacioni shoqëruese.

Deputetët propozues:

Nora Malaj
Florida Kërpa
Irejdë Mehmeti

Silva Caka
Gëzim Bërdinaku
Klajda Gjoka